

FTESË PËR TË APLIKUAR PËR TRAJNIMIN E ICT PËR PËRMIRËSIMIN E
SHKATHTËSIVE DIGJITALE DHE BIZNESORE TË FUQISË PUNËTORE TË SEKTORIT
KOSOVAR TË ICT SIPAS TRENDEVE TË INDUSTRIËSË GLOBALE

(Semesteri i parë)

Njihe ICT, dhe mëso si ta praktikosh atë për avancimin tuaj

Të nderuar/a,

WEglobal, në konsorcium me European Management dhe Prishtina REA, po implementojnë projektin "**Mbështetja e BE-së për Konkurrueshmërinë e Sektorit Kosovar të ICT**", financuar nga zyrja e BE-së në Kosovë.

Projekti do të mbështes rritjen e sektorit kosovar të ICT duke ofruar kurse trajnimi për pjesëmarrësit që të zhvillojnë shkathtësitë digjitale dhe biznesore për të mbështetur tregun e punës së ICT si dhe për të vënë në shfrytëzim efektiv shkathtësitë e përmirësuara. Qëllimi i përgjithshëm është nxitja e konkurrueshmërisë së bizneseve kosovare digjitale dhe tradicionale duke mbështetur rritjen e sektorit të ICT në Kosovë e cila do të sjell rritje dhe krijim të vendeve të reja të punës.

Projekti po fillon me **semestrin e parë të ofrimit të Trajnimit për Zhvillimin e Shkathtësive të ICT** për të përmirësuar kapacitetet e ICT të Fuqisë Punetore nga fusha e ICT në Kosovë, duke synuar ofrimin e këtij Trajnimi të Zhvillimit të Shkathtësive të ICT për mesatarisht rreth 240 individë siç përshkruhet më poshtë;

Objektiva

Objektiva e Programit të Trajnimit në ICT është të ofrojë një trainim të përditësuar të Shkathtësive të ICT bazuar në kërkesat dhe nevojat e bizneseve kosovare të ICT si dhe trendeve globale.

Grupet e targetuara

Grupi i targetuar i programit trainues janë të rinjt nga fusha e ICT (siç janë: të diplomuarit, ndërmarrësit e rinj, profesionistë të tjerë, meshkuj/gra të cilët dë shirojnë të avancojnë shkathtësitë e tyre digjitale, etj), profesionistët e bizneset aktuale të ICT në përpjekje për plotësimin e nevojave të tregut. Planifikohet të përfitojnë të paktën 240 të rinjë në çdo semestër.

Datat e trajnimit:

Semestri i parë i trainimit zhvillohet në mes të datës **5 tetor 2020 dhe 5 shkurt 2021**, me **4 orë** trainimi në ditë (nga **17:00-20:00**), katër ditë në javë. Do të ofrohen **300 orë** trajnimi duke përfshirë edhe **20 orë** praktikë shtesë për provimet finale.

Lokacionet:

Trajnimit do të ofrohet në 7 regjionet e Kosovës (Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Gjiilan, Ferizaj, Prizren, Gjakovë).

Qasja e trajnimit:

Trajnimit do të bazohet në parimet e të mësuarit për të rriturit, kurset trajnuese do të jenë interaktive me ushtrime praktike dhe shembuj nga jeta reale, duke kaluar përmes një modeli të një projekti përkrahës të ICT dhe shkathtësive digjitale nga fillimi deri në fund. Të gjithë trajnerët kanë eksperiencë në ICT dhe Shkathtësi Digjitale, me eksperiencë vendore dhe ndërkombëtare, të cilët i kanë të njohura ndryshimet që dija e përvoja në shkathtëtë e ICT mund të sjell.

Temat e Trajnimit:

Programi Trajnues i ICT përfshinë kurrikulën bërthamë (p.sh. Java Development, Cyber Security, Soft Skills Development – IT Project Management), si dhe kurse shtesë pilotuese në Application Development duke përdorur Python dhe Modern WEB Site Building me teknologji HTML/CSS (niveli medium/i avancuar).

Kategoria e Trajnimit

Java Development #250 orë

Cyber Security #250 orë

HTML/CSS, Java Scripting
#250 orë

Kurset Trajnuese

Java Programming
Android Application
Development

Skathtësi të buta (30 orë)
Testim & Certifikim (20 orë)

Cyber Security

Skathtësi të buta (30 orë)
Testim & Certifikim (20 orë)

HTML/CSS, Java Scripting

Skathtësi të buta (30 orë)
Testim & Certifikim (20 orë)

Si shtesë e kurseve trajnuese si më lartë, do të ofrohet edhe 1 sesion në formë të punëtorisë me prezentimin e trendeve më të reja nga Teknologjia Informativë si guidë për sektorin e TIK-ut.

Çertifikimi:

Projekti do të çertifikojë të trajnuarit e suksesshëm pas përfundimit të provimeve finale, gjë që do të mbështesë punësimin e tyre.

PSE të aplikoj:

- Ju do të bëheni një **ekspert programimi** dhe do të fitoni shkathtësitë e nevojshme për punësimin tuaj të ardhshëm,
- Projekti do të ofrojë trajnim të **cilësisë së lartë** në linjë me trendet ndërkombëtare dhe nevojat e industrisë së ICT, i cili do të ofrohet nga një ekip i trajnerëve me përvojë të gjerë ndërkombëtare dhe vendore dhe do të sigurojë që të trajnuarit do të jenë të gatshëm për punë në industrinë e ICT sapo të përfundojnë programin trajnues,
- Do të ofrohen Internships (**punë praktike**) në kompanitë e ICT në Kosovë dhe jashtë vendit,
- Agjencia e Punësimit do të mbështesë pjesëmarrësit e suksesshëm me programet e **internshipit dhe vetë-punësimit**,
- Përfshirja e pjesëmarrësve të suksesshëm në **aktivitetet e Projektit**

Të drejtë aplikimi kanë:

Përsoneat të cilët dëshirojnë të aplikojnë për trajnim, duhet t'i përmbushin kriteret siç janë cekur në formën e regjistrimit të aplikacionit në WEB faqen e projektit. Secili aplikant duhet të regjistrohet në semestrin e parë përmes

IT Training Platform të projektit:

e.ickosovo.eu

Tel. +38344926157

info@ickosovo.eu

Adresa: Sheshi Edita Durham, Nr.1, Prishtinë, Kosovë

fb.com/KosovoICTSupport

Afati i aplikimit:

Aplikacionet do të fillojnë nga **02 Shtator 2020**, të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë aplikacionet më së largu deri më 21 Shtator 2020. Projekti do të kontaktojë me aplikantët në bazë të rezultateve të procesit të selektimit sipas kriterëve për aplikim. Aplikantët inkurajohen të aplikojnë sa më shpejtë që kanë mundësi, duke përzgjedhur në listën prioritare aplikantët me përparësi.

BE PART OF US!

APLIKO TANI! >